



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË

| Nr. | Emri i Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore | Titulli i projektit | Përshkrimi i projektit |
|-----|--|---|---|
| 1 | Bashkia Durrës | Rindërtim i Qendrës Rinore Multifunkionale Durrës | Qëllimi i përgjithshëm i projektit është përmirësimi i infrastrukturës rinore përmes ndërtimit të Qendrës Rinore Multifunkionale, për mbështetjen e zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme me karakter edukativ, kulturor apo social të të rinjve të Bashkisë Durrës |
| 2 | Bashkia Gjirokastrë | TRY- Gjirokastra | Qëllimi i përgjithshëm i projektit është rritja e aksesit të të rinjve në punësim, kulturë e vendimmarrje përmes rikonstruksionit të objektit të Kinemasë së qytetit duke e përshtatur në një qendër multifunkionale për organizim aktiviteteve dhe ofrim shërbimesh për të rinjtë. |
| 3 | Bashkia Lushnje | Të rinjtë për të rinjtë | Qëllimi i përgjithshëm i projektit është krijimi i “Klubeve të Leximit”, përmes përmirësimit të infrastrukturës së Bibliotekës së qytetit, duke e përdorur ambientin për realizimin e takimeve periodike dhe aktiviteteve të klubit të leximit duke shfrytëzuar pajisjet për zhvillimin e potencialit krijues dhe inovator për zbatimin e e ideve lidhur me teknologjinë dhe inovacionin, nga të rinjtë e Bashkisë Lushnje. |
| 4 | Bashkia Dibër | Biblioteka dhe të rinjtë | Qëllimi i përgjithshëm i projektit është rikonstruksioni i katit të dytë të Bibliotekës (rreth 120m ²) duke e kthyer në një qendër multifunkionale dhe rekreative, të përdorshme nga të rinjtë për organizimin e takimeve rinore dhe krijimin e aksesit në shërbime si: edukim formal dhe joformal, kulturë e informacion, aktivitete që synojnë promovimin dhe organizimin e iniciativave të propozuar “nga” dhe “për” të rinjtë e Bashkisë Dibër. |
| 5 | Bashkia Kamëz | Bashkë për një rini aktive | Qëllimi i përgjithshëm i projektit është ndërtimi i ambientit të Pallatit të Kulturës në një ambient të shfrytëzueshëm për salla Bibiloteke dhe Aktivitete Rinore, me qëllimin krijimin e kushteve komforte për qëndrimin në Bibiloteke, realizimin e aktiviteteve kulturore dhe shkëmbimin e eksperiencave duke shmangur diferencat fizike e kulturore, të të rinjve të Bashkisë Kamëz. |